



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

**Më datë: 30 janar 2014**

## **Akademia e Kosovës për Siguri Publike**

### **RISHPALL KONKURS**

Për zgjedhjen e personelit të **rregullt akademik** në Fakultetin e Sigurisë Publike, si në vijim:

- 1. Një mësimdhënës për lëndët:** Fillet e së drejtës, E drejtë administrative, Procedurë administrative;
- 2. Një mësimdhënës për lëndët:** Inteligjenca dhe hetimi, Siguria e informatës, Terrorizmi, Inteligjenca dhe analiza;
- 3. Një mësimdhënës për lëndët:** Lidershipi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, Menaxhimi i rrezikut, Menaxhmenti financiar, Menaxhmenti dhe zhvillimi organizativ;

***Personeli i rregullt (me orar të plotë) akademik, do të angazhohet për mësimdhënie akademike, kërkime shkencore -mësimore, mësimdhënie në trajnime si dhe në zhvillimin e kurikulave.***

Zgjedhja e personelit të rregullt akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 26/2013 për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet të dorëzojnë:

- Kërkesën për aplikim;
- Një cv profesionale (modeli europass);
- Certifikatën e lindjes (jo me e vjetër së 6 muaj);

- Kopjen e diplomës, të studimeve themelore, master/magjistraturë, dhe doktoratës (të noterizuara);
- Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- Vendimin për nostrifikimin e diplomës (kandidatet që kanë mbaruar studimet jashtë vendit).
- Vendimin e zgjedhjes së fundit (kandidatet të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës);
- Si dhe informata tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për aplikantin.

Njohja e gjuhës angleze apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj, është përparësi për konkuresit.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, Ndërtesa e re administrative, Zyra e Personelit nr.01.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në gazetë, respektivisht deri me datën 13.02.2014.

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

*Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ofron kushte të përshtatshme për kërkime dhe hulumtime shkencore me qëllim të arritjes së rezultateve konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Andaj inkurajohen të aplikojnë kandidat me thirrje shkencore PhD, në fushat e kërkuaara.*

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: <https://aksp.rks-gov.net>.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit, në numrin e tel: 028 570 008 Ext 233, prej orës 08:00 - 1600.